REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
AGENCIA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY
Dep. DPKI
Nr. Prot 06-02/203/21
Broj strranica 04
Data 02-02-2021
PRISHTINE

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1, nëparag. 1.5, nenit 11 paragrafi 1, nëparag. 1.1, nenit 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit, me datë 02.02.2021, nxjerrë këtë:

V E N D I M

I. **Mbyllet rasti Nr. AKK–DPKI-06-2781/20, për zyrtarin z. Bujar Pira, Anëtar i Komisionit të Ankesave në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.**

II. **Rasti mund të rihapet në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.**

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin z. Bujar Pira, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (në vijim: LPKI).

Ky rast ka filluar të trajtohet pas informatës së pranuar nga një palë e tretë, me pretendimin për konflikt të interesit pasi që z. Bujar Pira, në cilësi të anëtarit të Komisionit të Ankesave në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA), ka qenë pjesë e vendimmarrjes me rastin e shqyrtimit të ankesës së Kolegjit Universum, të parashtruar kundër Vendimit Nr. Ref. 566/20D të datës 22.06.2020, të Këshillit Shtetëror të Cilësisë të AKA-së.

Sipas këtij pretendimi, z. Bujar Pira është profesor në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (USHAF) dhe Prorektor për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Sigurim të Cilësisë në këtë Universitet, ndërsa Kolegji Universum ka njësinë e tij edhe në Ferizaj. Andaj, sipas pretendimit të raportuesit të rastit, z. Bujar Pira është dashur ta shmangë këtë situatë sepse i njëjti ka interes financiar nga USHAF pasi që merr pagë nga ky institucion dhe se USHAF dhe Kolegji

Universum, si institucione që ofrojnë programe studimi për studentë, kanë veprimtari të njëjtë duke pasur qëllim që të regjistrojnë studentë në institucionet e tyre, siç është rasti në Ferizaj.

Me qëllim të sqarimit të këtij rasti, Agjencia kundër Korrupsionit (në vijim: Agjencia) ka kërkuar nga AKA-ja dokumentacion dhe informata shtesë lidhur me procesin e vendimmarrjes së Komisionit të Ankesave në AKA, për ankesën e Kolegjit Universum (shkresa zyrtare: DPKI-06-2978/20). Agjencia ka pranuar nga AKA-ja përgjigjen së bashku me dokumentacionin dhe informatat e kërkuara (shkresa zyrtare: DPKI-06-2978-1/20).

Në bazë të dokumentacionit në dispozicion, Agjencia ka konstatuar gjendjen faktike si në vijim:

Më datë 31.10.2019, Kolegji Universum ka aplikuar pranë Këshillit Shtetëror të Cilësisë në AKA, për akreditim të degës dhe akreditim/riakreditim të programeve të studimit. Këshilli Shtetëror i Cilësisë në AKA, me Vendimin Nr. Ref. 566/20D të datës 22.06.2020, ka refuzuar kërkesën e Kolegjit Universum për akreditim/riakreditim të katër programeve të studimit: Gjuhë Angleze, BA, 180 ECTS; Fizioterapi, BA Profesional, 180 ECTS; Teknik i Radiologjisë, BA Profesional, 180 ECTS dhe Gazetari Digjitale, BA Profesional, 180 ECTS. Kundër Vendimit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë, Kolegji Universum ka parashtruar ankesë në Komisionin e Ankesave të AKA-së.

Komisioni për Ankesa në AKA, me Vendimin KA/Nr. 2908/20 të datës 23.11.2020, ka pranuar pjesërisht si të bazuar ankesën e Kolegjit Universum, ka shfuqizuar Vendimin e Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe ka obliguar AKA-në që për programin Gazetari Digjitale, BA Profesional, 180 ECTS, të vazhdojë me procedura sipas dispozitave ligjore të përcaktuara në Udhëzimin Administrativ (MASHT) Nr. 15/2018 për akreditim të institucioneve të arsimit të lartë.

Me Vendimin e Drejtorit të AKA-së Nr. 1448/20D të datës 04.09.2020, janë emëruar tre anëtarë të përhershëm dhe dy anëtarë alternativ/rezervë të Komisionit të Ankesave në AKA. Sipas këtij Vendimi, z. Bujar Pira është emëruar si anëtar alternativ/rezervë i Komisionit të Ankesave në AKA.

Me dispozitat e nenit 12 të Rregullores Nr. 02/2019 për procedurën e ankesave pranë Komisionit të Ankesave të Agjencisë së Kosovës për Akreditim, është përcaktuar roli dhe funksioni i anëtarëve alternativ/rezervë të Komisionit të Ankesave në AKA, si dhe obligimi i anëtarëve të këtij komisioni për të deklaruar dhe shmangur konfliktin e interesit.

Sipas Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit të Ankesave të AKA-së, e mbajtur më datë 11.11.2020, njëri nga tre anëtarët e përhershëm të Komisionit të Ankesave të AKA-së, kryesuesi i këtij komisioni, ka deklaruar konfliktin e interesit dhe ka dalë nga takimi me rastin e shqyrtimit dhe vendosjes për ankesën e Kolegjit Universum. Këtë anëtar të Komisionit të Ankesave e ka zëvendësuar, konform dispozitave të Rregullores Nr. 02/2019, anëtari alternativ z. Bujar Pira, i cili më pas ka marrë pjesë në shqyrtimin dhe vendosjen për ankesën e Kolegjit Universum. Kjo për faktin se edhe anëtari tjetër alternativ/rezervë i Komisionit të Ankesave të AKA-së, ka deklaruar se ka konflikt të interesit lidhur me ankesën e Kolegjit Universum.

Me nenin 64 të Statutit të USHAF-së është përcaktuar se në përbërje të USHAF-së janë këto njësi akademike - fakultete: Fakulteti i Menaxhmentit; Fakulteti i Inxhinierisë dhe Informatikës; Fakulteti i Arkitekturës, Dizajnit dhe Teknologjisë së Drurit; Fakulteti i Turizmit dhe Ambientit dhe Fakulteti i Arteve të Aplikuara. Ndërsa me nenin 8 të Rregullores së USHAF-së Nr. prot. 47/20 të datës 09.01.2020, për studimet themelore (bachelor), janë përcaktuar këto programe akademike: Menaxhment Industrial (Bachelor Shkencor), Menaxhment i Turizmit dhe Hotelerisë (Bachelor Shkencor), Inxhinieri Industriale dhe Informatikë (Bachelor Shkencor), Arkitekturë të Interierit dhe Dizajni i mobileve (Bachelor Shkencor), Dizajni dhe Konstruksionet e produkteve nga Druri (Bachelor Profesional) dhe Dizajni Grafik dhe Multimedia (Bachelor Profesional).

Rrjedhimisht, asnjëri nga njësitë akademike – fakultetet e USHAF-së, përkatësisht asnjëri nga programet akademike të studimit që ofron ky universitet, nuk janë as të njëjta e as të ngjashme me programet që kanë qenë objekt i çështjet me rastin e shqyrtimit dhe vendosjes për ankesën e Kolegjit Universum nga Komisioni i Ankesave të AKA-së, anëtar i të cilit ka qenë edhe z. Bujar Pira.

Pas konstatimit të gjendjes faktike si më lartë, Agjencia konform dispozitave të LPKI-së, me shkresën zyrtare DPKI-06-02/54/21, e ka njoftuar zyrtarin z. Bujar Pira lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pas kësaj, është organizuar dhe mbajtur një takim me zyrtarin në zyrat e Agjencisë, me ç'rast z. Bujar Pira është njoftuar me pretendimet e palës së tretë dhe me faktet që posedon Agjencia.

Z. Bujar Pira, gjatë takimit të mbajtur në Agjenci ka paraqitur pikëpamjet dhe argumentet e tij lidhur me pretendimin për konflikt të interesit. I njëjti ka pranuar se është profesor në USHAF dhe Prorektor në këtë Universitet, por ka mohuar se ka pasur ndonjë interes privat apo të personave të afërm me të, me rastin e pjesëmarrjes së tij në cilësi të anëtarit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, në shqyrtim dhe vendosje lidhur me ankesën e Kolegjit Universum. Ndërsa, ka kundërshtuar pretendimin se USHAF dhe njësia e Kolegjit Universum në Ferizaj kanë veprimtari të njëjtë dhe janë konkurrente për të pranuar studentë, për faktin se asnjëri nga programet e Kolegjit Universum që kanë qenë objekt i çështjes së ankesës të cilën e ka trajtuar Komisioni i Ankesave të AKA-së, nuk është i njëjtë me drejtimet dhe programet që ka USHAF.

Agjencia konform mandatit të saj ka analizuar me kujdes të gjithë informacionin dhe dokumentacionin në dispozicion, përfshirë legjislacionin relevant në fuqi, lidhur me pjesmarrjen e z. Bujar Pira, në cilësi të anëtarit alternativ të Komisionit të Ankesave të AKA-së, në shqyrtimin dhe vendosjen për ankesën e Kolegjit Universum, dhe më pas ka vlerësuar se kjo situatë nuk përbënë konflikt të interesit. Kjo për faktin se një situatë e tillë nuk bie ndesh me nenin 6 dhe nenin 17 paragrafi 1, lidhur me nenin 3 paragrafi 1, nënparagrafët 1.2 dhe 1.6 të LPKI-së. Rrjedhimisht, nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

Së këndejmi, me nenin 6 të LPKI-së është përkufizuar nocioni i konfliktit të interesit, ashtu që: *"Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund*

të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare".

Tutje me dispozitën e nenit 17 [Deklarimi rast për rast i interesave private të zyrtarit], paragrafi 1 të LPKI-së është përcaktuar se: *"Çdo zyrtar gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vetëdeklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat ose të personave të afërm me të lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhet shkak për lindjen e një konflikti të interesit dhe të tërhiqet nga kjo vendimmarrje."*

Me nenin 3 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të LPKI-së është përkufizuar se: "*interesi privat i personit zyrtar - nënkupton çfarëdo përparësie për personin zyrtar, familjen e tij, të afërmit, miqtë dhe personat apo organizatat me të cilat ai ka pasur apo ka marrëdhënie afariste."* Ndërsa me nënparagrafin 1.6 të këtij nenin është përkufizuar se: *"person i afërm me zyrtarin është – bashkëshorti ose personi që bashkëjeton, të afërmit në vijë të drejtë të gjakut pa kufizime, të afërmit në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt, adoptuesi, i adoptuari, i afërmi në gjini të krushqisë deri në shkallën e dytë si dhe çdo person fizik apo juridik i cili ka pasur ose ka një lidhje të përbashkët interesi privat pasuror ose jopasuror me zyrtarin. Për qëllime të këtij ligji, personi juridik konsiderohet si person i afërm, sipas dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Kosovës".*

Në rastin konkret, në kuptim të dispozitave të sipërshënuara, nuk është gjetur se z. Bujar Pira ka pasur interes privat apo të personave të afërm me të, për çështjen në të cilën ka marrë pjesë në cilësi të anëtarit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, me rastin e shqyrtimit dhe vendosjes për ankesën e Kolegjit Universum.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në pikën I. të dispozitivit të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 paragrafi 11, të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihapë rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit